



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR
DURRES

Numri i Çështjes	71041-00068-11-2020	Data e Regjistrimit	1/9/2020
Numri i Vendimit	11-2020-2699	Data e Vendimit	7/11/2020

VENDIM
NE EMER TE REPUBLIKËS

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR DURRES E PERBERE NGA:

KRYESUES: Rexhep Bekteshi

ANËTAR

SEKRETARE Brunilda Dizdari

Objekti: Heajen e masës së sigurimit "Sekuestro preventive" mbi pasurinë:
1- Apartament banimi Ap.49 me Sip. 100 m2, ku 88.5m2 është sipërfaqe banimi, 11.5 m2 sipërfaqe e perbasliket me ndodhje ne katin e katërt. "Kontratë per Sipërmarrje (Pronotim) pasuri të paluajtshme me Nr.Rep.2612 dhe Nr.Kol.1559, me porositëse Znj.***** *****".

Baza Ligjore : Neni 274 te K.Pr.Penal

Përmbledhja e vendimit:

<?xml:namespace prefix = "o" ns = "urn:schemas-microsoft-com:office:office" />

Në gjykim mori pjesë Prokurori i çështjes Pali Deçolli.

Gjykata shqyrtoi materialet e çështjes dhe provat e paraqitura nga pala kërkuese dhe prej prokurorit të çështjes Pali Deçolli që i administroi në seancë gjyqësore e në përfundim të shqyrtimit gjyqësor dëgjoi avokaten mbrojtëse Brunela Kullolli që përfaqësoi në gjykim kërkuesen ***** ***** dhe nga Gjykata kërkoi: Pranimin e kërkesës së bërë sipas objektit të saj, në zbatim të nenit 274 pika 3 të Kodit Procedurës Penale.

Prokurori i çështjes Pali Deçolli deklaroi se hetimet lidhur me objektin ku ndodhet apartamenti që kërkohet heqja e sekuestros preventive janë duke vazhduar për shkak se me Vendimin penal të datës 14.02.2020 të Prokurorisë janë ndarë (veçuar) në procedim penal më vehte.

Prokurori i çështjes Pali Deçolli në përfundim të shqyrtimit gjyqësor deklaroi se kërkesa e bërë nga kërkuësja ***** ***** është e mbështetur në prova, fakte dhe në ligj e nga Gjykata kërkoi: Të pranohet kërkesa e bërë nga kërkuësja ***** ***** dhe të hiqet masa e sigurimit "Sekuestro preventive" për apartamentin Nr. 49, në objektin pallat me 9 kate mbi tokë e 1 kat nën tokë i ndodhur në Lagjen Nr. 13, Plazh-Durrës, me sipërfaqe 100 m2, dhe i pronotuar nga kërkuësja ***** *****.

Gjykata pasi shqyrtoi materialet e çështjes,

Vëren:

<?xml:namespace prefix = "o" ns = "urn:schemas-microsoft-com:office:office" />

Se mbi bazën e kërkesës së bërë nga ***** e Rrethit Gjyqësor Durrës me Vendimin



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR
DURRES

penal Nr. 106, datë 30.03.2018, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës ka vendosur:

1. Pranimin e kërkesës të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës.

2. Vendosjen e masës së sigurimit “Sekuestro preventive” mbi pasurinë objekt 9 kate mbi tokë + 1 kat nën tokë, i ndodhur në Pasurinë Nr. 9/219, Zona Kadastrale 8515, në Lagjen Nr. 13, Plazh-Durrës.

Vendimi penal i mësipërm është lënë në fuqi dhe nga Gjykata e Apelit Durrës me Vendimin penal Nr. 9/10-201-9, datë 04.01.2019 të saj.

Nga materialet e çështjes e paraqitura për shqyrtim del se kërkuesja ***** në objektin e mësipërm i ndërtuar nga shoqëria e ndërtimit “Braka Konstruksion” sh.p.k. me administrator Amarild Braka, disponon apartamentin me sipërfaqe 100 m2, i ndodhur në katin e gjashtë të objektit të mësipërm.

Ky fakt del nga kontrata për sipërmarrje (Pronotim) pasuri e paluajtshme me Nr. 2612 Rep. e Nr. 1559 Kol., e datës 05.11.2019 e lidhur midis shoqërisë ndërtuese “Braka Konstruksion” sh.p.k. dhe shtetasës (kërkueses) ***** , e paraqitur me cilësinë e provës në gjykim.

Nga kontrata e mësipërme del se vlera e apartamentit të porositur nga kërkuesja ***** me sipërfaqe 100 m2, e me numër 49, i ndodhur në katin e gjashtë të objektit 9 kate mbi tokë+1 kat nën tokë është përcaktuar në shumën 50.000 Euro.

Rezulton se objekti i mësipërm është ndërtuar në mënyrë të parregullt fillimisht nga shoqëria “Blombo-Konstruksion” sh.p.k. me administrator Arben Binjaku, që nuk e ka tërhequr lejen e ndërtimit dhënë me Vendimin Nr. 3, datë 09.07.2010 të K.R.R.T-Durrës dhe më pas punimet kanë vazhduar nga shoqëria “Braka Konstruksion” sh.p.k. me administrator Amarild Braka që ka përfutur të drejtat mbi objektin e mësipërm.

Nga administratori i shoqërisë së ndërtimit Amarildo Braka mbi objektin e ndërtimit në mënyrë të paligjshme janë kryer punime në dy katet e fundit të godinës, që i përkasin kateve 7 dhe 8, e ai në zyrën e Aluizmit-Durrës ka paraqitur dokumentet të rreme për legalizimin e objektit që realisht është 9 kate mbi tokë dhe 1 kat nën tokë.

Nga provat e paraqitura del se apartamenti Nr. 49, me sipërfaqe prej 100 m2, ndodhet në katin e gjashtë të objektit (pallatit) dhe se nuk ka lidhje të drejtpërdrejtë me veprimet e parregullta të kryera nga administratori Amarild Braka në katet e mësipërme të objektit, fakt që në gjykim u parashtua prej prokurorit të çështjes Pali Deçolli.

Kërkuesja ***** në kërkesën e bërë ka kërkuar heqjen e masës së sigurimit “Sekuestro Preventive” mbi apartamentin Nr. 49, me sipërfaqe 100 m2, që ndodhet në katin e gjashtë të objektit dhe që i përket asaj duke parashtuar se veprimet përkatëse për apartamentin e mësipërm i ka kryer konform rregullave ligjore me shoqërinë e ndërtimit “Braka Konstruksion” sh.p.k. që ka ndërtuar objektin-pallatin e mësipërm.

Në gjykim Gjykata dëgjoi prokurorin e çështjes Pali Deçolli që deklaroi se procedimi penal për objektin 9 kate mbi tokë dhe 1 kat nën tokë ishte veçuar dhe hetimet vazhdojnë. Ai shtoi se apartamenti Nr. 49, me sipërfaqe 100 m2, ndodhet në katin e gjashtë të objektit, ndërsa veprimet e parregullta nga administratori i shoqërisë së ndërtimit Amarild Braka janë kryer në katet e mësipërme.

Prokurori i çështjes Pali Deçolli deklaroi se kërkesa e bërë nga shtetasja ***** është e mbështetur në prova e fakte dhe është e ligjshme e nga Gjykata kërkoi të pranohet kërkesa



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR
DURRES

duke hequr masën e sigurimit “Sekuestro Preventive” vetëm për pasurinë apartament banimi me sipërfaqe 100 m2, e ndodhur në katin e gjashtë të objektit-godinë 9 kate mbi tokë+1 kat nën tokë, i ndodhur në pasurinë Nr. 9/219, Zona Kadastrale 8515, në Lagjien Nr. 13, Plazh-Durrës, në zbatim të nenit 274 të Kodit Procedurës Penale.

Gjykata analizoi me kujdes provat e faktet dhe konkludon se kërkesa e bërë nga kërkuesja ***** është e mbështetur në prova e ligj dhe duhet pranuar.

Për keto arsye:

Baza Ligjore:

Në zbatim të nenit 274 pika 3 të Kodit Procedurës Penale Gjykata:<?xml:namespace prefix = "o" ns = "urn:schemas-microsoft-com:office:office" />

Vendosi:

1. Heqjen e masës së sigurimit “Sekuestro Preventive” vetëm për pasurinë-apartament banimi Nr. 49, me sipërfaqe 100 m2, i ndodhur në katin e gjashtë në pasurinë objekt: 9 kate mbi tokë+1 kat nën tokë pasuri numër 9/219, Zona Kadastrale 8518, në Lagjien Nr. 13, Plazh-Durrës-sipas kontratës së sipërmarrjes (Pronotim)-pasuri e paluajtshme me Nr. 2612 Rep. e Nr. 1559 Kol., datë 05.11.2019, me porositëse kërkuesen *****<?xml:namespace prefix = "o" ns = "urn:schemas-microsoft-com:office:office" />
2. Shpenzimet gjyqësore siç janë bërë.
3. Një kopje e këtij vendimi i dërgohet Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit Durrës brenda 15 ditëve nga e nesërmja e shpalljes së tij.

U shpall sot më datë 30.06.2020.

Ky dokument është marrë nga www.gjykata.gov.al. Ai ka vlerë të plotë informuese, por nuk shërben si dokument zyrtar. Ky i fundit lëshohet nga autoritetet përkatëse.